

STATUT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Baia Blu” Sh.p.k

Kreu I

THEMELIMI, ZOTËRIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më datë 19/02/2025, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Baia Blu” Sh.p.k.**

Themeluesit e shoqërisë janë:

-Z. Eugen VERDHA, i datelindjes 30.01.1987, lindur ne Lushnje, Shqiperi dhe banues ne Divjake, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me dokument identifikimi me numer BD5282548 dhe numer personal I70130029A, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,

-Z. Lili RRUDHO, i datelindjes 13.04.1994, lindur ne Divjake, Shqiperi dhe banues ne Divjake, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me dokument identifikimi me numer 033291623 dhe numer personal J40413033U, me vullnet të lire, të plote si themelues i kesaj shoqerie ne te cilen eshte ortak,

Neni 2

Objekti

Shoqëria ka si objekt kryesor të saj:

- Kryerjen e veprimtarise ne fushen e ndertimit (Te gjithë gamen e ndertimit si psh elektrike kondicionimi, civile hidraulike etj), studimit, projektimit, supervizimit, kolaudimit, konsulences, mirmbajtjes, sherbimeve, turizmit, prodhimit, import-eksport, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private.
- Ndertimin, prishjen dhe rikonstruksionin e godinave civile, objekteve industriale, centraleve te ndryshem , objekteve turistike, objekteve me qellim agroturizmin, objekteve te kultit, rrjetet inxhinierike etj.
- Ndertimin, mirembajtjen dhe rikonstruksionin e rrugeve, autostradave, mbikalimeve, hekurudha e tramvaj, metrove e pistave aeroportuale.

- Ndertimin, prishjen, rikonstruksionin dhe mirembajtjen e impianteve te prodhimit te energjise elektrike, ndertimet e nenstacioneve, kabinat e transformatoreve linja e tensionit te ulet, mesem, te larte dhe shperndarje te energjise, si dhe cdo ndertim tjetër qe perben send te paluajtshem ne perfundim.
- Import eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te Energjise Elektrike, pajisjeve elektrike dhe aparaturave elektronike, produkte, mallra dhe lende te para te perdorimit industrial dhe te pergjithshem, makinerive, pajisjeve per perdorim industrial dhe te pergjithshem, mobilje, pajisje zyre dhe mjete informatike tj. Prodhimin e paisjeve dhe makinerive te permendura me siper.
- Projektimin, supervizim dhe zbatimin e projekteve dhenien e konsulences, asistences teknike dhe kryerjen e sherbimeve ne lidhje me veprimtarite e mesiperme.
- Projektim dhe instalim i impianteve elektrike, teknologjike, termike, hidrike, te ventilimit ftohje-ngrohjes (kondicionimit), furnizimit me gaz, i impianteve ngritese dhe transportuese (ashensore, shkalle levizese, transportues), te sinjalistikes rrugore etj.
- Studime fizibiliteti ne fushen e ushtrimit te veprimtarise se shoqerise me promovimin e shkembimeve tregtare nga Shqiperia- jashte vendit dhe anasjellas.
- Bar-Restorant-Hoteleri
- Shit-Blerje te pasurive te paluajtshme etj.
- Etj

Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, si dhe mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtperdrejt ose tërthorazi me objektin.

Neni 3 **Forma Ligjore**

- 3.1 Shoqëria ka formën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me ligjin për shoqëritë tregtare në Republikën e Shqipërisë.
- 3.2 Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj.

Neni 4 **Baza ligjore**

- 4.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji i Shoqërive Tregtare”), i ndryshuar dhe çdo dispozitë tjetër të zbatueshme të legjislacionit shqiptar.

Neni 5 **Kohëzgjatja e Veprimtarisë**

- 5.1 Shoqëria krijohet për të vepruar për një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në QKB, Tiranë. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mundet të mbyllë veprimtarinë e saj kur e shihet e arsyeshme apo në raste të parashikuara në ligj.

Neni 6

Selia/Adresa e Regjistruar

- 6.1 Shoqëria **“Baia Blu” Sh.p.k**, do të ketë seline të saj në qytetin e Tiranës, adresë, Rruga ALBANOPULI, në numrin e pasurisë 9/842-N11, Rezidenca RAINBOW Tiranë.
- 6.2 Administratori, në përputhje me kompetencat që i jep statuti mund të hapë adresë sekondare të shoqërisë që kanë lidhje vetëm me aktivitetin e përcaktuar në Nenin 2, “Objekti i veprimtarisë”.

KREU II

Neni 7

Kapitali themeltar

- 7.1 Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë do të jetë në vlerë monetare (para) dhe në natyrë (Truall).
- 7.2 Vlera e përgjithshme e Kapitalit themeltar fillestar i Shoqërisë do të jetë **12,972,400** (*Dymbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind*) Lekë, nga të cilat :
1. Në para do të jenë **10,000,000** (*Dhjetë milion*) Lekë.
 2. Në natyrë do të jetë truall me vlerë **30,000** (Tridhjetë mijë) Euro, e konvertuar me kursin e datës 19.02.2025 të bankës së shqiptarisë (99.08) është **2,972,400** (*Dy milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e katërqind*) Lekë
- 7.3 Trualli me vërtetim pronësie, me Nr. 7/1, ndodhur në zonën kadastrale 1430, Libri 1, Fq 14, Indeksi 70 me adresë Sarandë, Cukë , Berdenesh që do të vendoset si kapital është pronë e **Z. Eugen Verdha** dhe **Z.Lili Rrudho** e ndarë në mënyrë të barabartë me nga 50%, kjo ndarje korespondon dhe me ndarjen e kuotave të kompanisë midis dy ortakëve. Të dy ortakët pranojnë me marrveshje të vendosin truallin si kapital të kompanisë **“Baia Blu” Sh.p.k**
- 7.4 Kapitali i shoqërisë është i ndarë në 2 pjesë (kuotë) me vlerë nominale **6,486,200** (Gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë një kuotë, nga e cila:
- 1-Në para do të jetë **5,000,000** (*Pesë milion*) Lekë dhe,
 - 2-Në natyrë do të jetë **1,486,200**(Një milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind).
- Edhe kuota tjetër do të jetë **6,486,200** (Gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind) lekë, nga e cila:
- 1-Në para do të jetë **5,000,000** (*Pesë milion*) Lekë dhe,

2-Në natyrë do të jetë **1,486,200**(Një milion e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind).

7.5 Kuotat do të zoterohen nga ortakët sipas ndarjes së mëposhtme:

a. Z. Eugen VERDHA, zotërues i 50 % të kapitalit të Shoqërisë

b. Z. Lili RRUDHO, zotërues i 50 % të kapitalit të Shoqërisë

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit

8.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me 60% te votave te ortakëve.

8.2 Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kërkojnë interesat e shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve. Do t'u ofrohen për nënshkrim kuota të reja vetëm ortakëve ekzistues të Shoqërisë. Nëse kuotat e reja do tu ofrohen për nënshkrim një pale të tretë atëherë duhet miratimi me Shumicë të Cilësuar i Asamblesë së Ortakëve.

8.3 Ortakët mund të financojnë shoqërinë nëpërmjet financimeve me pagesa, pa interes, qoftë si kontribute në kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Në rastet kur shoqëria do të gjendet përballë rasteve të nevojshme për zmadhimin e kapitalit nëpërmjet financimit të ortakëve të shoqërisë, atëherë ortakët angazhohen të kryejnë financimet përkatëse.

8.4 Mënyra e rritjes së kapitalit në lidhje me metodat dhe afatet e pagimit të kontributeve nga ortakët do të vendoset rast pas rasti me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të përfshijnë ndër të tjera dënimet dhe pasojat për një ortak në rast të mos-pagesës së kontributit të rënë dakord në afatin dhe shumën e caktuar duke përfshirë, po pa u kufizuar, (i) zvogëlimin proporcional të pjesës të ortakut në Shoqërisë, (ii) shitjen e detyruar të pjesës së ortakut në Shoqëri, (iii) përcaktimit, në bazë të një vlerësimi profesional ose formule, të vlerës së cilësdo pjesë të ortakut që është paguar, dhe shitjen e detyruar të asaj pjese në vlerën e përcaktuar.

8.5 Pavarësisht sa më sipër, zmadhimi i kapitalit nuk do të zvogëlojë pjesët e interesit të ortakëve në kapitalin e shoqërisë, përveç se kur të gjithë ortakët janë dakord.

Neni 9

Zvogëlimi i Kapitalit

9.1 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e statutit.

9.2 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

9.3 Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të dëmtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek ata që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit. Në të kundërtën Gjykata e konsideron të pavlefshëm këtë vendim mbi kërkesën e kreditorëve.

Neni 10

Transferimi i kapitalit. Kufizimet mbi transferimin

- 10.1 Kuotat e kapitalit të shoqërise me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - b) shitblerjes;
 - c) trashëgimisë;
 - d) dhurimit;
 - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.
- 10.2 Nëse një ortak vdes bashkëzotëruesit e mbetur gjallë dhe trashëgimtarët e tij janë të vetmit persona të cilët Shoqëria i njeh si titullarë të kuotës të tij; asnjë dispozitë e këtushme nuk e çliron pasurinë e ortakut të vdekur nga përgjegjësia në lidhje me kuotën që ka pasur në zotërim i vetëm ose bashkërisht.
- 10.3 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku mundet që pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, të vendosë ose të bëhet zotëruesi i kuotës ose të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër i caktuar prej tij. Nëse vendos të bëhet zotërues vetë, ai e njofton shoqërinë në lidhje me këtë. Nëse vendos që të kërkojë që si zotërues i kuotës të regjistrohet një person tjetër, ai shfrytëzon një instrument të kalimit të kuotës te ky person tjetër.
- 10.4 Personi që e fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku gëzon të drejtat, titullar i të cilave do të kishte qenë si zotërues i kuotës, me përjashtim të faktit që, përpara se të regjistrohet pranë QKR-së, ai nuk gëzon të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në Asamblenë e Ortakëve.
- 10.5 Transferimi i kuotave tek palët e treta ose ndërmjet ortakëve mund të bëhet vetëm me anë të një kontrate me shkrim dhe pasi të jenë plotësuar kushtet në vijim:
- 10.6 Në çdo rast tjetër të transferimit të pjesëve të kapitalit jashtë strukturës të ortakërisë, ortakët gëzojnë të drejtën e parablerjes. Ortaku i cili dëshiron të transferojë kuotën e tij do të njoftojë ortakët e tjerë nëpërmjet një njoftimi me shkrim dhe forme elektronike, i cili duhet të përcaktojë dhe kushtet e transferimit.
- Ortakët e shoqërisë njoftojnë qëllimin e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes brenda 60 ditëve nga njoftimi. Në rast se asnjë prej ortakëve nuk ushtron të drejtën e parablerjes brenda afatit të përcaktuar më sipër, atëherë ortaku që kërkon të largohet ka të drejtë të transferojë tek të tretët kuotën e tij.
- Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjet në mënyre solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës nga çasti i kalimit të kuotave deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi vendimarrës

11.1 Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

11.2 Çdo kuotë garanton të drejtën e një vote në asamblenë e përgjithshme të ortakëve (“**Asambleja e Ortakëve**”), të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet drejtuese , të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimit të Shoqërisë si dhe të drejtat e siguruar nga ky Statut, marrëveshjet midis ortakëve dhe parashikimet e Ligjit Tregtar.

11.3 Vetëm Asambleja e Ortakëve do të ketë të drejtë të vendosë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b. modifikimin dhe ndryshimin e këtij Statuti;
- c. të vendosë për emërimin dhe shkarkimin e administratorëve të Shoqërisë;
- d. miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- e. të zmadhojë dhe/ose zvogëlojë kapitalin e regjistruar;
- f. vendosë për shkrirjen, prishjen, likuidim dhe çdo lloj transformimi tjetër të Shoqërisë;
- g. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- h. të themelojë dhe/ose mbyll degë dhe përfaqësi jashtë dhe brenda Shqipërisë;
- i. të miratojë raportet vjetore dhe bilancet dhe të miratojë shpërndarjen e fitimit;
- j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k. të vendosë mbi përvetësimin, shitjen dhe vendosjen e barrës mbi pasuritë;
- l. të vendosë mbi shit-blerjen e pasurive;
- m. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë ;
- n. të vendosë pagën, shtesa në pagë dhe shperblimet e Administratorit;
- o. të vendosë për caktimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- p. të vendosë mbi organizimin strukturor dhe administrativ të Shoqërisë;
- q. të vendosë mbi buxhetin vjetor;
- r. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures së veprimtarisë;
- s. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- t. të vendosë për çdo çështje tjetër, që i takon për zgjidhje asamblesë së ortakëve, me ligj dhe/ose sipas këtij statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 12

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve

- 12.1 Vendimet, të listuara më sipër, në lidhje me ndryshimin e këtij Statuti, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, marrjen e huave apo dhënien e garancive nga Shoqëria, organizimin dhe shpërndarjen e Shoqërisë kërkojnë një shumicë prej 60 % të ortakëve prezentë ose të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit të parashikuara në Nenin 14 më poshtë (“**Shumicë e Kualifikuar**”). Të gjitha vendimet e tjera të Asamblesë së Ortakëve mund të miratohen me shumicë të zakonshme të ortakëve prezent apo të përfaqësuar në asamble, në bazë të kërkesave të kuorumit në Nenin 14 më poshtë (“**Shumicë e Zakonshme**”). Vendimet e Asamblesë së Ortakëve për caktimin e administratorit miratohen me Shumicë të Zakonshme.

Neni 13

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve

- 13.1 Asambleja e Ortakëve do të thirret nga Administratori i Shoqërisë nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike të paktën një herë në vit në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të përcaktuar në njoftim brenda gjashtë muajve të parë të çdo viti kalendarik për të miratuar pasqyrat financiare të Shoqërisë të vitit të mëparshëm financiar.
- 13.2 Asambleja e Ortakëve do të thirret me njoftim me shkrim të lëshuar nga administratori, i cili duhet t’u dërgohet përfaqësuesve të ortakëve me letër rekomande ose faks ose postë elektronike (e-mail) jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara ditës së caktuar për asamblenë. Njoftimi për ortakët duhet të përcaktojë datën, orën dhe vendin e mbledhjes së asamblesë si dhe çështjet për t’u diskutuar (rendi i ditës) dhe, në rast të një asambleje të zakonshme të ortakëve, duhet të përfshijë pasqyrat e plota financiare dhe raportin e administrimit.
- 13.3 Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligji të Shoqërive Tregtare.

Neni 14

Vendimet e miratuara në Asamblenë e Ortakëve, Kuorumi

- 14.1 Në rastin e vendimeve të miratuara me Shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë prezent ortakët me të drejtë vote që kanë më shumë se 50% të kuotave të nënshkruara.
- 14.2 Në rastin kur Asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë Shumicë të kualifikuar, Asambleja e Ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm

- nëse janë prezent ortakët që zotërojnë më shumë se 60% e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike,.
- 14.3 Nëse Asambleja e Ortakëve është e mbledhur në mënyrë korrekte, por numri i kërkuar i ortakëve për të plotësuar kuorumin nuk është prezent apo nuk është i përfaqësuar, asambleja e ortakëve do të mblidhet sërish në përputhje me parashikimet e Nenit 14 por jo më vonë se 30 ditë. Rendi i ditës i asamblesë së dytë nuk do të ndryshojë.
- 14.4 Kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk është thirrur sipas formaliteteve të ligjit ose këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë të pranishëm dhe shprehen dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
- 14.5 Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që ai të formalizohet me shkrim.
- 14.6 Asambleja e përgjithshme vendos me 60% e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Neni 15

Procesverbalet e Asamblesë së Ortakëve

- 15.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Ortakëve duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit si dhe ti bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 15.2 Procesverbali i Asamblesë së Ortakëve nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Kryetari i Asamblesë së Ortakëve do të zgjidhet nga ortakët e pranishëm në Asamblenë e Ortakëve, me Shumice të thjeshtë para fillimit të asamblesë, ndërsa mbajtësi i procesverbalit do të caktohet nga kryetari i Asamblesë së Ortakëve. Asambleja e Ortakëve mund të vendosë që procesverbali të mbahet nga një noter publik në të cilin rast nuk është e nevojshme caktimi i mbajtësit të procesverbalit dhe nënshkrimi i procesverbalit nga kryetari i mbledhjes. Esktraktet e procesverbalit të Asamblesë së Ortakëve për qëllim depozitimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit janë të vlefshme nëse nënshkruhen nga të gjithë ortakët pjesëmarrës në Asamblenë e Ortakëve ose nga Administratori i Shoqërisë.

Neni 16

Përjashtimi nga e drejta e votës

- 16.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Ortakëve merr vendime për:
- a. vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja;

dhe çdo rast tjetër të parashikuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

- 16.2 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 17

Administrimi i Shoqërisë dhe kompetencat e administratorit

- 17.1 Shoqëria do të administrohet nga një administrator, i emëruar në përputhje me këtë statut.
- 17.2 Administratori i Shoqërisë mund të shkarkohet nga pozicioni që ka në Shoqëri në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumice të Zakonshme.
- 17.3 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë në mënyrë të plotë për administrimin e zakonshëm të saj si edhe të drejtën për të miratuar të gjitha vendimet që i gjykon të përshtatshme për arritur dhe përmbushur qëllimin e shoqërisë, me përjashtim të vendimeve që me ligj i takojnë Asamblesë së Ortakëve.

Administratori mund të autorizojë palë të treta për ta përfaqësuar atë në transaksione të veçanta me anë të një prokure të hartuar para noterit.

- 17.4 Personat e mëposhtëm do të caktohet si Administrator i Shoqërisë për një afat **3 vjeçar**:

-Z. Lili RRUDHO, i datelindjes 13.04.1994, lindur ne Divjake, Shqiperi dhe banues ne Divjake, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me dokument identifikimi me numer 033291623 dhe numer personal J40413033U.

Të drejtat dhe detyrimet e Administratorit janë ato të përcaktuara në Ligjin e Shoqërive Tregtare, këtë Statut, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe rregullat e brendshme të administrimit të Shoqërisë.

- 17.5 Administratori ka të drejtat dhe detyrimet si e mëposhtme:
- a. përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - b. hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - c. përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave, me miratim me shkrim nga ortaket;
 - d. nënshkrimin e të gjithë dokumenteve, lëshimin e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - e. vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori nuk do të kenë kufizim.
 - f. mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë;

- g. punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, dhe pagesave të stafit, pa miratimit me shkrim nga ortakët;
- h. marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, ngritjen e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratori mund të udhëzojë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojë shumën e shpërblimit të tyre me miratimin paraprak të Asamblesë së Ortakëve;
- i. administratori ka të drejtë të ngrejë padi dhe t'i tërheqë ato, të nënshkruajë marrëveshje gjyqësore, të mbyllë marrëveshje arbitrazhi, të caktojë arbitra, të tërheqë paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërpresë procedimet por në cdo rast përpara kryerjes së ndonjë prej veprimeve të mësipërme, administratori duhet të marrë miratimin e me shume se 60% te kuotave te Ortakëve te Asamblesë.
- j. ndërmarrjen e të gjithë veprimeve të tjera që i takojnë aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
- k. mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e kontabilitetit;
- l. përgatitjen e pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga auditorë të jashtëm nëse kjo kërkohet nga ligji ose nga një vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve;
- m. thirrjen e mbledhjeve të Ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përmbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së përgjithshme të Ortakëve për shpalljen e vendimeve përkatëse;
- n. të vendosë në dispozicion të Ortakëve të Shoqërisë sa herë që të kërkohet prej tyre informacionet, raportet dhe dokumentet në lidhje me shpenzimet e Shoqërisë, gjendjen e llogarive bankare, inventarin, deklarata për të hyrat, deklarata të tjera financiare, fletëparaqitjet tatimore të Shoqërisë dhe auditet, nëpërmjet formës së kërkuar dhe njoftuar nga secili Ortak, si p.sh. nëpërmjet faxit, postës elektronike apo postës së zakonshme.
- o. administratori është i detyruar të therrase asamblenë e përgjithshme të Ortakëve në rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- p. Te kryej regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- q. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve , i paraqet këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- r. çdo detyrë tjetër të parashikuar në ligj.
- s.

KREU IV
VITI FINANCIAR – EKSPERTËT- BILANCI

Neni 18
Viti Financiar dhe Dividendi

- 18.1 Viti Financiar i aktivitetit të Shoqërisë përkon me vitin kalendarik, fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më datë 31 Dhjetor.
- 18.2 Pas përcaktimit të fitimit të Shoqërisë në përputhje me pasqyrat financiare dhe pas përmbushjes së kërkesave së nenit 77 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, fitimi i Shoqërisë, deri sa të shlyhet shuma e investimit fillestar, ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së tyre në shoqëri.
- 18.3 Fitimi do t’u shperndahet ortakëve cdo fund viti financiar, ne raport me kuotat e zoteruara.
- 18.4 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund te vendose me 60% te votave, qe fitimi te mos u shperndahet ortakëve ne fund te vitit financiar.

Neni 19
Eksperti(ët) Kontabël të Autorizuar

- 19.1 Eksperti(ët) Kontabël i Autorizuar do të emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, nëse është e nevojshme.
- 19.2 Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.
- 19.3 Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 20
Bilanci, Mbajtja e Llogarisë

- 20.1 Bilanci i Shoqërisë kontrollohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve dhe duhet të përgatitet për t’ju paraqitur organeve tatimore përpara përfundimit të muajit mars të vitit pasues.

- 20.2 Librat e llogarisë duhet të mbahen në gjuhën shqipe dhe në monedhën vendase (Lek). Shoqëria mund të mbajë llogari të veçanta në monedhë të huaj, shuma e të cilave duhet të konvertohet, çdo muaj, në monedhën vendase.
- 20.3 Shoqëria mund të marrë financime nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë arsye Shoqëria mund të vendosë barrë siguruese mbi kuotat si garanci, ose mund të hipotekojë pasurinë e paluajtshme të saj, me vendim të Asamblesë së Ortakëve të marrë me Shumicë të Cilësuar.

KREU V

PRISHJA – RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 21

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë nga Asambleja e Ortakëve me Shumicë të Cilësuar:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë ;
- e) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej shoqërisë emrin e likudatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesi i emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesit, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues. Likuiduesi(t) do të përgatisin raportin e likuidimit, i cili përmban një përmbledhje të gjendjes ekonomike të Shoqërisë, hapat e likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tij. Në fund të këtij procesi, Asambleja e Ortakëve do të kontrollojë bilancin përfundimtar dhe do të japë miratimin për përfundimin e procedurës së likuidimit.

Neni 22

Largimi dhe përjashtimi i Ortakut

Largimi dhe përjashtimi i ortakut do të kryhet në përputhje me nenet 101, 102 dhe 103 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 23

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të asamblesë së ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 24

Marrëdhëniet e punës

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës së punes dhe legjislacionit të punës në fuqi. Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të punësuarit janë të detyruar që të respektojnë Statutin e kësaj Shoqërie dhe rregullat e brendshme të saj. Të punësuarit duhet të përgjigjen për dëmet që i shkaktojnë kësaj Shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Neni 25

Ndryshimet në Statut

Dispozitat e këtij Statuti mund të ndryshohen nga Asambleja e Ortakëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 26

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 27

Dispozita Përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 3 ekzemplare me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhëshqipe, u miratua në parim nën parafshirje nga Ortakët e shoqërisë tregtare **“Baia Blu” sh.p.k.**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën orgjinale.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“Baia Blu” sh.p.k.

Z. Eugen VERDHA

Z.Lili RRUDHO